



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 100, datë 31.05.2019

**PËR
MIRATIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME, NË
KLASAT E JO-JETËS**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 199, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e shoqërisë “First Investment Bank Albania” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërive të sigurimit “Albsig” sh.a., “Intersig VIG”sh.a., “Eurosig” sh.a., “Atlantik” sh.a.
2. Miratimin e z. Ardit Cikuli, zj. Liljana Fasllija, zj. Sonilda Bajraktari, zj. Anika Kane, zj. Elva Çaushti, z. Uran Begaj, z. Robert Sejdiaj, z. Devis Osman, z. Bledar Kapllani, z. Ervin Ceca dhe z. Rafael Hoxha për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të “First Investment Bank Albania” sh.a.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI